



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 11. 12.2013, në orën 11.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e Komisionit: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Kymete Bajraktari, Albana Gashi dhe Kimete Bytyçi.

Munguan: Justina Shiroka – Pula dhe Duda Balje.

Stafi mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi – Zyrtar i lartë ligjor, Sulltane Gashi - zyrtare ligjore dhe Burim Tahiri – mbështetës i Komisionit.

Pjesëmarrësit e tjerë: Lejla Selimi- OSBE, Nuredin Ibishi -UNDP, Shkumbin Asllani-CRDP dhe Selvete Gerxhaliu- Grupi për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdaliu- kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19 nëntor 2013;
3. Miratimi i Udhëzuesit për Peticione;
4. Raportimi i grupeve punuese për ecuritë e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve: Ligji për Personat e Zhdukur, Ligji për Personat e Verbër;

5. Organizimi i takimit me përfaqësuesit e shoqatave: të personave me aftësi të kufizuara; personave të verbër dhe të personave të zhdukur;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19 nëntor 2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 19 nëntor u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i Udhëzuesit për Peticione

Kryetarja- Tha se udhëzuesin e Peticioneve e kemi shqyrtuar edhe më herët, kemi pasur disa vërejtje dhe e kemi analizuar prapë, janë komplikuar disa gjëra. Ky udhëzues duhet të jetë i qartë, si për qytetarët, ashtu edhe për Komisionin. Në rregulloren e Kuvendit është pika që parasheh shqyrtimin e peticioneve, dhe çdo udhëzues duhet me qenë në harmoni me rregulloren e Kuvendit. Mirëpo ky udhëzues parasheh edhe angazhimin e një punëtori shtesë, ku unë mendoj se nuk është e arsyeshme, sepse nuk ka shumë ankesa për të angazhuar punëtorë shtesë. Unë e kam parë edhe formularin për parashtrimin e ankesës në Institucionin e Avokatit të Popullit bashkë me palosjen dhe është një formularë shumë i thjeshtë dhe i qartë. Ajo tha se duhet të përshtatet udhëzuesi dhe të mos komplikohet puna për parashtruesin e petitionit dhe Komisionin.

Albana Gashi- Tha se edhe mbledhjen e kaluar kemi pasur vërejtje sa i përket udhëzuesit për shqyrtimin e peticioneve. Mendoj se është i komplikuar, kam pasur vërejtje edhe në të dy format e formularit, deri tani kemi punuar dhe kemi shqyrtuar petitionet ne baze të rregullores së kuvendit. Në miratimin e këtij udhëzuesi është mirë të mos ngutemi, por ta analizojmë prapë mirë sepse është më e drejtë të vonohemi dhe të bëjmë një punë të mirë.

Kurtan Kajtazi- Tha se nuk po vërej diçka të paqartë sa ju përket formularëve, janë shumë të thjeshtë dhe të saktë, ky udhëzues është për Komisionin dhe nuk është i komplikuar. Ne mund ta bëjmë një fletëpalosje të thjeshtë dhe të qartë për qytetarin me të dhëna të sakta për të qenë ai sa ma i informuar, por udhëzuesi në detaje i shërben Komisionit dhe legjislaturave të ardhshme, kemi punuar mjaft gjatë në këtë udhëzues dhe nuk po vërej se dikush ka ndonjë propozim konkret se çka të plotësohet, apo të ndryshohet. Prandaj unë propozoj që ky udhëzues të miratohet.

Rita Hajzeraj-Beqaj- Tha se udhëzuesi i Komisionit duhet të ketë dallime dhe ka specifikat e veta sa i përket udhëzuesve të Institucionit të Avokatit të Popullit, sepse ne kemi procedurat për pjesëmarrje në dëgjime publike, kthimin e dokumenteve e plotësimin e tyre. Mendoj se për nevojat e Komisionit është i nevojshëm një udhëzues më i qartë dhe më i gjerë, e për nevoja të qytetarëve mund të bëjmë fletëpalosjen më të thjeshtë me formularin me të dhënat kryesore se

çka duhet të përmbajë kërkesa e tij, jam për thjeshtësim të këtij udhëzuesi, por të mos ja humbim kuptimin sepse është dokument që i parasheh procedurat e shqyrtimit të petitionit në Komision.

Kryetarja- Tha se ka vërejtjet e saj rreth këtij udhëzuesi, sepse nuk po behet udhëzuesi për anëtarët e Komisionit. Ne i dimë autorizimet tona, por qytetari po na parashton kërkesa edhe kur është procedura gjyqësore, sepse nuk e kanë të qartë se në cilat raste kanë të drejtë të drejtohen në Komision, deri më tani kemi pasur raste të rralla që deklaratën e kemi paraqitur në Kuvend, por kjo varet prej natyrës së petitionit, sepse kemi pasur raste kur kemi kërkuar debat në Kuvend. Sa i përket formularit tha se nuk është shumë problem dhe paraqiti disa vërejtje, se duhet të hiqet komplet faqja 2, duhet të ketë përmirësime në përmbajtje, në faqen 5, fjala petitioner nuk është në fjalorin e gjuhës shqipe dhe duhet të jetë parashtruesi i petitionit, sepse kjo është me komplikime për qytetarin. Ajo tha se ky udhëzues nuk i plotëson kushtet që të miratohet në këtë mbledhje.

Kymete Bajraktari- Tha se këtë udhëzues kemi kërkuar ta bëjmë për anëtarët e Komisionit sepse në rregulloren e Kuvendit shume gjera nuk janë të përcaktuara në detaje dhe ky udhëzues është bërë për anëtarët e Komisionit dhe jo për qytetarët, sepse grupi punues i cili ka shqyrtuar petitionet shumë herë ka hasur në vështirësi pasi që rregullorja e kuvendit nuk jep shumë qartësi rreth zgjidhjeve të peticioneve.

Kurtan Kajtazi- Tha se udhëzuesi do të publikohet në ueb- faqe të Kuvendit dhe qytetarët e interesuar kanë mundësi ta drejtojnë një petition në mënyrë të rregullt duke marrë udhëzime nga ky udhëzues në ueb- faqe të Kuvendit, sepse ky ofron informata të bollshme edhe për qytetarët.

Albana Gashi- Tha se duhet të krijojmë kushte dhe mundësi që edhe një qytetar i cili nuk ka shumë njohuri dhe nuk është shumë i arsimuar të ketë mundësi adresimi për kërkesat e tij. Pra duhet të bëhet një udhëzues dhe një formular që i përshtatet gjendjes së popullatës në teren, dhe duke e pasur parasysh këtë, ne nuk duhet të komplikojmë procedura por t'i thjeshtësojmë aq sa ka mundësi në mënyrë që qytetarët të kenë qasjen sa më të lehtë.

Lidhur me këtë ajo tha se nuk mund ta dinë të gjithë qytetarët se çka realisht përmban kjo rregull andaj ishte e mendimit që të jetë sa më e thjeshtë dhe më e kuptueshme. Ajo në këtë rast ishte e mendimit që të jetë e rregulluar që të drejtën për të ushtruar petition ta kanë të gjithë qytetarët të cilët konsiderojnë që ju është shkelur ndonjë e drejtë.

Kimete Bytyqi – Ishte e pajtimt që ka vërejtje në udhëzues të cilat janë reflektuar edhe nga praktika, si shembull ajo mori rastet kur personat nuk kanë ditur se kujt t'i drejtohen në rastin e paraqitjes së petitionit.

Kryetarja – Paraqiti një përmbledhje në të cilën kishte paraqitur vërejtjet e saj konkrete lidhur me përmbajtjen e udhëzuesit. Ajo në vazhdim paraqiti propozimin e saj që udhëzuesi të jetë Udhëzues për Komision dhe për qytetarë. Në këtë gjendje se si është udhëzuesi ajo tha se do të jetë i paqartë për qytetarin dhe ishte e mendimit që duhet të ketë thjeshtësime gjuhësore të përmbajtja e këtij udhëzuesi. Duke marrë parasysh faktin se ky udhëzues do të publikohet edhe në faqen e Kuvendit, ajo tha se do të marrin kritika edhe prej të tjerëve. Lidhur me këtë ajo ishte e mendimit që të bëhet një punëtori dhe aty të paraqiten vërejtjet konkrete të anëtarëve dhe në këtë mënyrë të ndryshohet dhe plotësohet ky udhëzues që shërben për shqyrtimin e peticioneve.

Kurtan Kajtazi – Duke u ndërlidhur theksoi se nuk është mirë që edhe më tutje të zvarritet çështja e miratimit të këtij udhëzuesi, sepse ka kaluar shumë kohë nga miratimi i parë i tij. Ai kërkoi nga anëtarët e Komisionit që secili sa më shpejt t'i paraqet vërejtjet konkrete me shkrim dhe të krijohen mundësitë për miratimin e këtij udhëzuesi.

Kryetarja- Konstatoj se pas këtij debati konstruktin Komisioni është i pajtimi që për shqyrtimin e mëtutjeshëm të këtij udhëzuesi të nxjerrë këtë:

Përfundim

Për finalizimin e punës së udhëzuesit për shqyrtimin e Peticioneve, në janar të vitit 2014 të mbahet një punëtori në të cilën do të paraqiten vërejtjet konkrete dhe pastaj do të bëhet miratimi i këtij udhëzuesi.

4. Raportimi i grupeve punuese lidhur me ecuritë e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, Ligji për Personat e Zhdukur dhe, Ligji për Personat e Verbër.

Kymete Bajraktari – Në cilësinë e kryetares së Grupit Punues për monitorimin e Ligjit për Personat e Verbër i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me aktivitetet e këtij grupi rreth monitorimit të ligjit. Në vazhdim ajo theksoi se ky ligj nuk është duke u zbatuar. Në takimet që janë bërë me Shoqatën e Personave të Verbër ajo tha se ata janë të shqetësuar për arsye se pagesa që është paraparë me këtë ligj nuk është duke u zbatuar edhe përkundër faktit që është futur në rishikimin buxhetor. Ajo po ashtu i njoftoi se i kanë vizituar Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe ajo konstatoi se asnjëra nga këto ministri nuk i ka nxjerrë aktet normative, gjë që rezulton në mos zbatimin e ligjit. Ajo i njoftoi edhe për planet e mëtutjeshme të cilat do t'i realizojnë më konkretisht ajo tha se do ta Vizitojnë Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe do ta organizojnë Dëgjimin Publik lidhur me këtë monitorim ku do të ftojnë përfaqësuesit e institucioneve kompetente, si dhe të Shoqatës së Personave të Verbër dhe në fund do ta paraqesin raportin lidhur me këtë monitorim i cili do të shoqërohet me rekomandimet përkatëse.

Albana Gashi – Në cilësinë e kryetares së Grupit Punues për Monitorimin e Ligjit për Personat e Zhdukur, i njoftoi anëtarët rreth aktiviteteve të këtij grupi punues. Ajo tha se ky grup punues ka realizuar gjashtë vizita në teren, përkatësisht në Klinë, Gjakovë, Meje, Suharekë, Krushë të Madhe dhe Krushë të Vogël. Rreth të gjeturave në këto vizita ajo theksoi se ky ligj nuk është duke u zbatuar marrë parasysh ato nene që kanë të bëjnë me familjarët e personave të zhdukur. Si beneficione të cilat i përfitojnë familjarët janë shpenzimet e varrimit të personit të gjetur. Problem tjetër që ajo paraqiti ishin problemet pronësore të cilat janë identifikuar gjatë këtyre vizitave, lidhur me këto raste ka pengesa në shfrytëzimin e pronës nga femrat familjare të personave të zhdukur nga pjesëtarët e tjerë të familjes, qoftë në shkallë më të largët të trashëgimisë, apo në shkallë të njëjtë, si dhe nga ndikimi në gjykata. Po ashtu ajo informoi se ka ankesa nga familjarët sa i përket beneficioneve dhe i njoftoi se ata ndihen si një kategori e diskriminuar në krahasim me kategoritë e tjera sa i përket realizimit të beneficioneve. Në vazhdim ajo tha se kjo kategori nuk i gëzon beneficionet, siç janë lehtësirat në shërbimet shëndetësore, në shkollim etj. Ajo tha se është në plan të realizohet një vizitë te familjarët e personave të zhdukur serbë. Lidhur me mbajtjen e Dëgjimit Publik ajo tha se do të mbahet në

muajin janar dhe pastaj do të paraqitet raporti me rekomandime që do të nxirren nga të gjeturat e këtij monitorimi.

5. Organizimi i takimi me përfaqësuesit e shoqatave të personave me aftësi të kufizuar, personave të verbër dhe familjarëve të personave të zhdukur

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit rreth caktimit të një date për mbajtjen e një takimi me përfaqësuesit e shoqatave të personave me aftësi të kufizuar, personave të verbër dhe familjarëve të personave të zhdukur. Ajo kërkoi pëlqimin e anëtarëve të Komisionit për mbajtjen e një kokteji ku do t'i ftonin personat e cekur më lart. Lidhur me caktimin e datës së mbajtjes së këtij kokteji ajo tha se duhet të marrin informacione nga administrata e Kuvendit se në cilën datë Kuvendi do të shkojë në pushim. Pastaj duhet respektuar datën e caktuar.

Kimete Bytyqi – duke u ndërlidhur me monitorimin e Ligjit për Personat e Zhdukur tha se është evidentuar edhe një e metë në realizimin e pagesave ndaj familjarëve të personave të zhdukur për shkak të statusit të personave të zhdukur. Ajo tha se familjarët i marrin pagesat për një person të zhdukur, mirëpo nuk marrin pagesë shtesë në qoftë se në një familja ka dy ose më tepër persona të zhdukur.

Kurtan Kajtazi – Duke u ndërlidhur theksoi se kjo çështje është në plan të rregullohet me Ligjin për vlerat e Luftës i cili është në procedim e sipër.

Kryetarja – Lidhur me këtë ligj theksoi se Titulli i Ligjit që është Ligji për Personat e Zhdukur nuk i përshtatet fare përmbajtjes që e ka dhe më mirë kishte qenë që ta ketë titullin. Gjatë raportimi ajo tha se duhet të kërkohet që këta familjarë të gëzojnë beneficione edhe në fushat e tjera.

Albana Gashi – Tha se në kohën e raportimit si rekomandim kryesor duhet të jetë kërkesa për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji dhe po ashtu në këtë ligj të përfshihen edhe beneficionet e tjera që duhet t'i takojnë familjarëve të personave të zhdukur. Ajo ishte e mendimit që shumë gjëra të ndërrohen në këtë ligj, ose ky ligj të titullohet Ligji për Komisionin Qeveritar për Personat e Zhdukur.

Kryetarja konstatoi se për këtë pikë të rendit të ditës Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Organizimi i takimi me përfaqësuesit e shoqatave të personave me aftësi të kufizuar, personave të verbër dhe familjarëve të personave të zhdukur të organizohet një koktej para datës së Krishtlindjeve dhe për datën e mbajtjes do të vendoset në takimin e radhës.

6. Të ndryshme

Rita Hajzeraj – Beqaj – E ngriti çështjen e Agjencisë së Privatizimit duke theksuar se në takimet e kaluara janë marrë vesh që të ftohen në Komision me qëllim të vërtetimit të gjendjes së krijuar, sepse ka pasur disa ankesa në këtë drejtim nga qytetarët.

Kryetarja- Konstatoi se për këtë çështje Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Për petitionet që kanë të bëjnë me çështjen e privatizimit të ftohen përfaqësuesit e AKP-së në takimin e radhës së Komisionit.

Mbledhja përfundoi në ora 11: 00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu